



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 114 Prot

Tiranë, më 30, 08, 2013

VENDIM QARKULLUES Nr. 265, datë 30, 08, 2013

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve Kaparjel, Zhulat, Lapidari, Kardhiq, Rehovë, Çepun, Picar, në Pellgun Ujëmbledhës të Lumit Kardhiq, (Komuna Cepo, Gjirokastër) mbi bazën e kërkesës së Subjektit "AE KARDHIQ" sh.p.k., Tiranë,

VENDOSI:

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve "Kaparjel, Zhulat, Lapidari, Kardhiq, Rehovë, Çepun, Picar, në Pellgun Ujëmbledhës të Lumit Kardhiq, (Komuna Cepo, Gjirokastër), paraqitur nga Subjekti "AE KARDHIQ" sh.p.k., Tiranë.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Gjirokastër bazuar në kontratën dypalëshe midis "AE KARDHIQ" sh.p.k., dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("AE KARDHIQ" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Gjirokastër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

VISAR ZHITI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
Web: [www.asha.gov.al](http://www.asha.gov.al)